

“Investment Sherko – ikub Group” shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 18

"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016**

	Shenime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	23,875,509	15,553,026
Llogari te arketueshme tregetare	5	2,090,375	-
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	6	30,240,041	14,341,518
Te tjera llogari te arketueshme	7	-	52,725
Total Aktive Afatshkurtra		56,205,925	29,947,269
Aktivitet afatgjata			
Aktive financiare	8	2,283,000	3,263,000
Total aktive afatgjata		2,283,000	3,263,000
Total Aktive		58,488,925	33,210,269
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura	9	1,811,278	2,158,600
Detyrime tatimore	10	8,903,592	391,523
Te tjera detyrime	11	-	200,000
Total Detyrime afatshkurtra		10,714,870	2,750,123
Detyrime afatgjata			
Total Detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		10,714,870	2,750,123
Kapitali aksionar			
Kapitali i nenshkuar	12	2,000,000	2,000,000
Rezerva ligjore		200,000	200,000
Fitimi i ushtrimit		45,574,055	28,260,146
Total kapitali aksionar		47,774,055	30,460,146
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		58,488,925	33,210,269

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Shenime	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	13	22,000,000	-
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	14	5,364,312	(29,388)
			-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(94,426)	(54,974)
1) Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-	-
2) Te tjera shpenzime	15	(94,426)	(54,974)
			-
Shpenzime te personelit	16	(8,527,858)	(2,967,528)
1) Paga dhe shperblime		(8,510,405)	(2,917,932)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore			
2) (paraqitur vecmas nga shpenzimet per pension)		(17,453)	(49,596)
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	17	(1,446)	(8,442)
Te ardhura te tjera		-	-
Shpenzime financiare	18	29,664,694	31,320,478
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme			
(paraqitur vecmas shpenzimet per t'u paguar tek			
1) njesite ekonomike brenda grupit)		29,664,694	31,320,478
Pjese e fitimit/humbjes nga pjesmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		48,405,276	28,260,146
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(2,831,221)	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(2,831,221)	-
Fitimi/humbja e vitit		45,574,055	28,260,146

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	2,000,000	200,000	-	17,992,477	20,192,477
Fitimi / Humbja e vitit				28,260,146	28,260,146
Dividendë të paguar				(17,992,477)	(17,992,477)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015	2,000,000	200,000	-	28,260,146	30,460,146
Fitimi / Humbja e vitit				45,574,055	45,574,055
Lëvizjet përmes kapitalit			28,260,146	(28,260,146)	-
Dividendë të paguar			(28,260,146)		(28,260,146)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	2,000,000	200,000	-	45,574,055	47,774,055

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori Investment Sherko – ikub Group shpk më 23 Janar 2017 dhe janë firmosur si më poshtë.



Migena SHERKO
Migena Sherko
Administrator

"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Shenime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	45,574,055	28,260,146
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	144,696	24,653
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(17,936,173)	1,284,983
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	8,164,747	401,760
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(200,000)	150,000.00
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	35,747,325	30,121,542
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera	980,000	(200,000)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	980,000	(200,000)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Dividendë të paguar	(28,260,146)	(17,992,477)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(28,260,146)	(17,992,477)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		
	8,467,179	11,929,065
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	15,553,026	3,648,614
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(144,696)	(24,653)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4 23,875,509	15,553,026

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

“ Investments Sherko – ikub Group është rregjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë rregjistrave të Qendrës Kombëtare të rregjistrimeve më datë 18 Janar 2012 me NIPT L21318042U. Selia e shoqërisë është në Rrugën Ismail Qemali Pallati 27 Shk1 Nr. 30. Kapitali i shoqërisë është 2,000,000 lekë. Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është Znj. Migena Sherko.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është Z. Romeo Sherko i cili zotëron 100% të kuotave të kapitalit.

Aktiviteti i shoqërisë është në fushën e shitjeve të licensave software dhe shërbimeve përkatëse të lidhura me to. Dhënia me qira e softwareve. Shërbime të adoptimit dhe të përshtatjes së softwareve. Shërbime suporti dhe mirëmbajtje të teknologjisë së informacionit, shërbime të konsulencës teknike në fushën e teknologjisë sv informacionit dhe aktivitete të tjera të subjekteve private e publike. Shërbime trajnimit dhe edukimi në fushën e teknologjisë së informacionit etj.

Më 31 dhjetor 2016 Shoqëria kishte 1 punonjës (2015: 1 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
Euro/LEK	135.23	137.28
USD/ LEK	128.17	125.79

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë. Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
Mjete monetare ne banke	23,868,094	15,545,271
Llogari rrjedhese	23,868,094	15,545,271
Mjete monetare ne arke	7,415	7,755
	23,875,509	15,553,026

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
Intelligent Systems Bullgaria	1,690,375	-
Pragmatic Software	400,000	-
	2,090,375	-

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
Te arketueshme tregtare ndaj paleve te lidhura	12,949,961	398,112
Financim per ikub.al	17,290,080	13,170,080
Financim per Romeo Sherko	-	373,326
Financim per Pragmatic software	-	400,000
	30,240,041	14,341,518

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arketueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
Tatim mbi fitimin	-	52,725
	-	52,725

8. Aktive financiare

Në llogaritë e tjera të arkëtueshme paraqiten Investimet në pjesemarrje që kompania zotëron në kompani të tjera :

Aktivët financiarë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
Investime ne pjesemarrje:		
Intelligent Systems Albania	-	980,000
IT Panakeia (ikubINFO Software Solutions)	400,000	400,000
ikub.al	1,800,000	1,800,000
ikubINFO	83,000	83,000
	2,283,000	3,263,000

9. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
Romeo sherko	1,713,078	2,060,400
ikubINFO Software Solutions	83,000	83,000
ikub.al	15,200	15,200
	1,811,278	2,158,600

10. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
TVSH e pagueshme	4,406,491	21,465
Kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	1,837	8,267
Tatimi mbi te Ardhurat nga Punesimi	1,716,768	39,027
Tatimi mbi fitimin	2,778,496	-
Tatim mbi Dividentin	-	322,764
	8,903,592	391,523

11. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u> ne Lek	<u>31 Dhjetor 2015</u> ne Lek
Detyrime ndaj personelit	-	200,000
	<u>-</u>	<u>200,000</u>

12. Kapitali aksionar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 2,000,000 Leke i ndarë në 2,000 kuota, i zotëruar 100% nga z. Roeo Sherko.

13. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 Dhjetor 2016</u> ne Lek	<u>31 Dhjetor 2015</u> ne Lek
Te ardhura nga konsulenca	22,000,000	-
	<u>22,000,000</u>	<u>-</u>

14. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga shitja e aktiveve financiare dhe nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 Dhjetor 2016</u> ne Lek	<u>31 Dhjetor 2015</u> ne Lek
Te ardhura nga investimet (shitja e aksioneve)	6,557,375	-
Vlera kontabel e Aktiveve Financiare te shitura	(980,000)	-
Humbje nga kursi I këmbimit	(213,063)	(29,388)
Fitim nga kursi I këmbimit	-	-
	<u>5,364,312</u>	<u>(29,388)</u>

15. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	-	300
Komisione bankare	27,086	22,409
Taksa te ndryshme	67,000	25,120
Shpenzime te tjera	340	120
Shpenzime te ndryshme dhe te panjohura	-	7,025
	94,426	54,974

16. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
Shpenzime per paga	8,510,405	2,917,932
Shpenzime per sigurime shoq e shend	17,453	49,596
	8,527,858	2,967,528

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2016 është 1 (2015:1).

17. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
Gjoba dhe penalitete	1,446	8,442
	1,446	8,442

18. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet dhe të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga dividendët dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
	ne Lek	ne Lek
Te ardhura nga dividendet	29,531,917	31,208,482
Te ardhura nga interesat	132,777	111,996
	29,664,694	31,320,478

Rakordimi i të ardhurave të deklaruara nv FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar nv FDP e TVSH është si më poshtë:

	Dhjetor 31, 2016
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne	
Shitje total te deklaruara ne FDP TVSH	28,689,053
Autofatura te deklaruara per blerje sherbime nga jashte shtetit	
Diference kursi nga parapagimet	
Shitje te dekluar ne FDP qe jane te ardhuran ne PASH	28,689,053
Shitje sherbime	22,000,000
Nga shitje e aksioneve	6,557,375
Interesa kredie	131,678
Te ardhura te deklaruara ne PASH te cilat jane deklaruar shitje ne FDP	28,689,053
Ndryshimi I gjendjes se PG	-
Fitime nga gabime te lejuara ne ushtrimet paraardhese	
Te ardhurat nga interesat	1,098
Të ardhura nga dividendi	29,531,917
Fitim nga kembimet valutore	
Total te ardhura te deklaruara FDP e Tatim Ftimit	58,222,069

19. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2015; 15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

Shoqëria ka fitim tatimor të paraqitur si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Fitimi para tatimit	48,405,276	28,260,146
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	1,446	15,467
Penalitet, gjoba e demshperblime	1,446	8,442
Shpenzime te tjera te panjohura	-	7,025
Te ardhura te perjashtuara nga tatimi mbi fitimin	(29,531,917)	(31,208,482)
Te ardhura nga dividendet nga investimet ne pjesmarrje	(29,531,917)	(31,208,482)
Humbje fiskale e mbartur		
Fitimi para tatimit	18,874,805	(2,932,869)
Tatim fitimi @15%	2,831,221	-
	<u>45,574,055</u>	<u>28,260,146</u>

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Tatimi Mbi Fitimin I parapaguar më 1 janar 2016/2015	52,725	52,725
Tatimi i vitit ushtrimor	2,831,221	0
Tatim Fitimi I Parapaguar 2016/2015	0	0
Tatim Fitimi I parapaguar/Per tu paguar	<u>2,778,496</u>	<u>52,725</u>

Të ardhurat e marra nga dividendët nga Investimet ne pjesmarrje nuk merren ne konsideratë në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, sipas nenit 26 te Ligjit 8438 "Per Tatimin mbi te ardhurat", dividendët dhe ndarjet e fitimit, kur ato shpërndahen nga shoqëritë e ortakëritë rezidente dhe shoqëritë jorezidente të huaja, që janë subjekte të tatimit mbi fitimin, pavarësisht nga kuota e pjesëmarrjes, në vlerë ose në numër, të kapitalit aksionar, të së drejtës së votës apo të pjesëmarrjes në kapitalin fillestar apo aksionar të përfituesit.

20. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Bilanci kontabël		
Të pagueshme ndaj palët e lidhura		
Romeo sherko	1,713,078	2,060,400
ikubINFO Software Solutions	83,000	83,000
ikub.al	15,200	15,200
	<u>1,811,278</u>	<u>2,158,600</u>

Të arketueshme nga palët e lidhura		
Te arketueshme tregtare ndaj ikubal	549,961	398,112
ikub.al	17,290,080	13,170,080
Te arketueshme tregtare ndaj ikubINFO	12,400,000	
Romeo Sherko		373,326
Pragmatic software		400,000
	<u>30,240,041</u>	<u>14,341,518</u>

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015</u>
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
Shitje palëve të lidhura		
ikub.al	131,678	111,482
ikubINFO	22,000,000	-
	<u>22,131,678</u>	<u>111,482</u>

21. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.